



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/77

Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 dhe duke pas për bazë Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 01/34 të datës 05.03.2018, Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 06/134 të datës 01.03.2017, Deklaratën e Përbashkët të Qëllimit të lidhur në mes të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik të Republikës Federale të Gjermanisë mbi Parkun Gjermano-Kosovar për Inovacion dhe Trajnim në Prizren, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Parcela me 39.25 hektarë tokë e regjistruar në emër të Republikës së Kosovës në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr. 06/134 të datës 01.03.2017 dhe e evidentuar në bazë të certifikatës me numër të Njesisë Kadastrale P-71813068-05290-0 të datës 28.07.2018, e cila në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr. 01/34 të datës 05.03.2018 është vënë në shfrytëzim për qëllime publike, për periudhën 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite me qëllim të zhvillimit të Parkut Gjermano-Kosovar për Inovacion dhe Trajnim, i jepet në shfrytëzim të përkohshëm Deutsche Gesellschaft für Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për qëllimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij Vendimi.
2. GIZ do të ketë të drejtën e përdorimit të parcelës si në pikën 1 të këtij vendimi për qëllime të përgatitjes dhe ruajtjes së hapësirave, me qëllim të themelimit dhe zhvillimit të Parkut Gjermano-Kosovar për Inovacion dhe Trajnim.
3. GIZ do të ketë në përdorim parcelën si në pikën 1 të këtij Vendimi nga momenti i lirimit të saj nga Kontigjenti Gjerman i KFOR-it e deri në themelimin dhe funksionalizimin e plotë të entitetit juridik i cili do të menaxhojë me Parkun Gjermano-Kosovar për Inovacion dhe Trajnim.
4. Komiteti i Përkohshëm Drejtues i themeluar sipas pikës 3 të Vendimit të Qeverisë Nr. 01/34 të datës 05.03.2018 do të mbikëqyrë punët përgatitore.
5. GIZ do të lejoj largimin e pajisjeve, kontenjerëve, objekteve të përkohshme, pastrimin e terrenit dhe të gjitha punët tjera të nevojshme për lirimin e hapësirave nga Ushtria Gjermane ("Bundeswehr") nga momenti i nxjerrjes së këtij Vendimi e deri në lirimin e plotë të hapësirave të parcelës.

6. Me qëllim të zbatimit të pikës 5 të këtij Vendimi, i lejohet qasja në hapësira Ushtrisë Gjermane, të gjithë kontraktorëve dhe nën-kontraktorëve të saj, sipas autorizimeve të lëshuara për GIZ sipas këtij Vendimi.
7. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e këtij Vendimi.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Komunës së Prizrenit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/77

Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Federatës së Xhudos së Kosovës për mbështetje financiare në vlerë 143,000 (njëqind e dyzet e tremijë) euro, edhe atë; 85,000 (tetëdhjetepesë mijë) euro për mbështetje të Ekipit Olimpik për përmirësimin e kushteve në Palestrën e Xhudos "Ippon" në Pejë dhe 58,000 (pesëdhjetë e tetëmijë) euro për blerjen e një kombi për udhëtim të Ekipit Olimpik.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Financave nën-programi Thesari me kod 11200 kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 03/77

Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Fana Rugova, bashkëshorte e Presidentit Historik Dr. Ibrahim Rugova, i lejohet transfer i mjeteve financiare në muaj në vlerë prej 1,000.00 (njëmijë) euro neto, automjet dhe një drejtues automjeti, i cili do të jetë në shërbim të saj.
2. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/77
Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Funkcionimin e Sistemit të Integruar Informativ për Zhvillim Ekonomik.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 05/77
Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 132 të Ligjit Nr. 06/L-034 Për Mbrojtjen e Konsumatorit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit.
2. Këshilli përbëhet nga gjashtëmbëdhjetë (16) anëtarë në këtë përbërje.
 - 2.1. Sherif Fejzullahu - Ekspert i pavarur, kryesues;
 - 2.2. Plator Gerdovci-Departamenti për mbrojtjen e konsumatorit/MTI, zëvendës kryesues;
 - 2.3. Berat Ahmeti - Inspektorati i Tregut/MTI, anëtar;
 - 2.4. Ibrahim Tershnjaku - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, anëtar;
 - 2.5. Hivzi Dragidella - Oda Ekonomike e Kosovës, anëtar;
 - 2.6. Lumnije Ajdini - Aleanca Kosovare e Biznesit, anëtare;
 - 2.7. Selatin Kaçaniku - OJQ - Konsumatori, anëtar;
 - 2.8. Venera Agani - Banka Qendrore e Kosovës, anëtare;
 - 2.9. Behxhet Bala - Zyra e Rregullatorit të Ujësjetës, anëtar;
 - 2.10. Rrezarta Ajeti-Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, anëtare;
 - 2.11. Petrit Haziri - Zyra e Rregullatorit të Energjisë, anëtar;
 - 2.12. Arsim Dreshaj - Komisioni i Pavarur për Media, anëtar;
 - 2.13. Hekuran Aliu - OJQ 'LENS', anëtar;
 - 2.14. Nora Jusufi - Instituti 'GAP', anëtare;
 - 2.15. Nora Bajrami - Lëvizja 'FOL', anëtare;
 - 2.16. Arbër Kadriu - Organizata 'Kallxo.com'', anëtar.
3. Këshilli harton dhe mbikëqyrë implementimin e Programit për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe i raporton Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë mbi zbatimin e Programit për Mbrojtjen e Konsumatorit, mbështetë ndryshimet në legjislacion dhe rregulloret ekzistuese.
4. Sipas nevojës dhe rrethanave, Këshilli mund të kërkojë informata shtesë dhe ekspertizë prej Institucioneve relevante të Republikës së Kosovës.

5. Pagesa e anëtarëve të Këshillit do të bëhet në lartësinë e përcaktuar me Vendim të Qeverisë, nr. 12/42, të datës 31.10.2008.
6. Ngarkohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për sigurimin e hapësirës dhe mbështetjes teknike për Komisionin me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së tij.
7. Këshilli vepron në bazë të nenin 132 të Ligjit Nr. 06/L-034 Për Mbrojtjen e Konsumatorit.
8. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me nr. 10/32 datë 20.02.2018.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/77

Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Aprovohet shpronësimi shtesë për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit të infrastrukturës - Ndërtimi i Autostradës Prishtinë-Hani i Elezit, Zonat Kadastrale: Preoc, Dobratin, Suhudoll, Uglarë, Lipjan, Babush i Muhaxherëve, Konjuh, Smallushë, Marec, Gadime e Ulët, Gadime e Epërme, Babush i Sërbeve, Cërnillë, Mirash, Rahovicë, Papaz, Sazli, Softaj, Pojatë, Talinoc i Muhaxherëve, Bibaj, Fshati i Vjetër, Komogllavë, Gërlicë, Rakaj, Sojevë, Koxhaj, Soponicë, Rekë, Nikaj, Biçec, Doganaj, Kaçanik i Vjetër, Kovaqec, Bob, Gajre, Gjurgjedell, Neqavc, Hani i Elezit, Pustenik dhe Paldenicë të Komunave Graçanicë, Lipjan, Ferizaj, Kaçanik dhe Hani i Elezit, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/77

Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit Ndërtimi i "Kullës së Demë Ahmetit" me qëllim të shndërrimit të saj në shtëpi muze për ruajtjen e vlerave historike të trashëgimisë historike dhe kulturore të Kosovës, Zona Kadastrale Reçicë, Komuna Podujevë, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave, Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK) dhe Komuna e Podujevës.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/77

Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Kambialin dhe Premtim Pagesën.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/77

Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Procedurën Kontestimore.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/77

Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Rendin dhe Qetësinë Publike.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/77
Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.
2. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 12/77

Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për negociimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Shkencor-Teknologjik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/77
Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, për kryesues dhe anëtar të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës këta kandidatë:
 - 1.1. Bajram Zejnullahu, kryesues;
 - 1.2. Hajzer Salihu, anëtar.
2. Vendimi, bashkë me biografitë e kandidatëve, i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë